



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I PERSONELIT/ DIVISION OF PERSONEL/ KADROVSKA SLUŽBA

K O N K U R S

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Titulli i punës: Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës

Kategoria funksionale /Koeficienti: 9

Numri i referencës: 24/2013

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Është përgjegjës për organizimin dhe përcjelljen e funksionimit të përgjithshëm të Qendrës Kinematografike të Kosovës.

Detyrat kryesore:

- Përcakton politikat operacionale për përmbushjen e detyrave të QKK dhe të vendimeve të Këshillit Drejtues;
- Organizon punët e përditshme si dhe motivon, mbikëqyr, vlerëson punën e personelit;
- Bën pranimin e punonjësve duke zbatuar procedurën e konkursit;
- Përfaqëson QKK dhe është përgjegjës për ecurinë e veprimtarisë së QKK në përputhje me ligjin;
- Përgatit dhe mbledh materialet për mbledhje të Këshillit Drejtues dhe harton aktet e vendimet tjera që janë në përgjegjësi të QKK;
- Përgatit raportet vjetore të QKK;
- Siguron mbajtjen e raporteve efektive e korrekte me Ministrinë e Kulturës, institucionet tjera, subjektet që merren me kinematografi, shoqatat profesionale të krijuesve dhe me partnerët homologë;
- Propozon juritë profesionale për përzgjedhjen e projekteve filmike për subvencionim;

Kushtet pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë përkatës dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave;

Dëshmi që nuk është nën hetime;

Dëshmi që nuk është anëtar i trupit ekzekutivë të ndonjë partie politike;

Procedura e konkurrimit:

Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Shkathtësitë kyçe, njohuritë, aftësitë:

- Aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxheriale për arritjen e rezultateve në punë;
- Shkathtësi të mira hulumtuese për hartimin e raporteve dhe të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Aftësi për të krijuar raporte pune ndërpersonale të shkëlqyeshme;
- Aftësi për të kuptuar shpejtë informacionin e ndërlikuar, në mënyrë të shpejtë të arrijë të kyçet në tema dhe çështje dhe të përcjellë në mënyrë efektive informacionet e ndërlikuara;
- Vetiniciativë, i gatshëm të merr përgjegjësi dhe të shfrytëzojë iniciativën e tij;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme të vetorganizimit, të jetë në gjendje që të krijojë përparësi në mënyrë efektive duke punuar në një ambient nën presion;
- Aftësi për përmbushjen e punëve të vështira, punëve të afatizuara dhe punëve grupore etj.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Diplomë universiteti në lëmin e kinematografisë dhe fushave të përafërta;
- Pesë (5) vjet përvojë pune relevante;
- Njohja e gjuhëve zyrtare të Kosovës e domosdoshme;
- Njohja e gjuhës angleze është e domosdoshme.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mandatin:

Bazuar në Ligjin për Kinematografinë.

Kohëzgjatja e mandatit: 4 vite

Data e mbylljes së konkurrimit: 11/12/2013

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 23 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, bulevardi "Nënë Tereza" nr. 35. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211054.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.